

Prozatori i ri, siç i thonë disa, është, në fakt, i moçëm dhe i vënë në sprovë si vetë Ballkani. Por një i sprovuar i qetë, që lëviz mes të fshehtave të ëmbla të lindjes dhe të vdekjes, të Fillimit e të Fundit, me një shpërfillje prej të pavdekshmi, apo mbase të një qënije racionale të ardhur nga një tjetër botë. **CORNELIU VLAD**

Mund të thuhet pa ngurrim se ky autor... është më i frytshmi autor i letrave shqipe në qindvjetshin e fundit!... Sa herë të lexosh libër (roman) të ri të të riut gjenial të letrave shqiptare, atij me emrin Ardian-Christian Kyçyku, aq herë do të mahnitesh. **BAJRAM SEFAJ**

Ardian-Christian Kyçyku është një nga vegimet e mëdhenj të prozës bashkëkohore. **DAN-SILVIU BOERESCU**

Ardian-Christian Kyçyku ka shkuar që tani shumë larg dhe shumë lart me veprën e tij. **HIQMET MEÇAJ**

Kyçyku është prozator vizionar, me fuqi shajnitëse, që praktikon një majeutikë të vërtetë ndaj kujtesës universale. **BOGDAN-ALEXANDRU STANESCU**

Ardian-Christian Kyçyku na shfaqet si një nga siluetat e kalibrit të madh në prozën e sotme... kontinentale... Ai ka aftësinë të ngjizë një univers imagjinar kolosal. **TITUS VIJEU**

Ardian-Christian Kyçyku ka dy atdhe letrarë, të cilëve u thurr lavde në ato që shkruan. I ardhur nga një trevë e pasqyruar në Ohrin mitik dhe nga një trysni e egër dhe shformuese ideologjike, historia e prozës së tij është, në fakt, triumfi i një talenti vigan. **IOLANDA MALAMEN**

Kemi të bëjmë me një prozator të madh, me të cilin duhet të mburremi që merr frymë pranë nesh... Romani "Një fis i lavdishëm e që jep shpirt" është një epope e vërtetë balkanike, një vepër me të cilën çdo letërsi, sado e madhe qoftë, do të krenohet. **PAUL VINICIUS**

Kyçyku është fëmija-mrekulli i një Rumanie që sjell ndërmend se dikur quhej Traki. Kyçyku është një nga tre shkrimtarët më të mëdhenj të gjuhës rumune. **VASILE ANDRU**

Është thënë, me një formulë fatlume, se ky shqiptar me banim në Rumani mund të quhet një Markez i Ballkanit. Por proza e tij, herë lakonike dhe herë voluminoze, nuk zhbiron vetëm gjeografinë e ngushtë të një hapësire të nëmur, por edhe kushtet e ekzistencës së mirëfilltë njerëzore. Në thellësitë e qënies së vet, Kyçyku është një filozof, për të cilin bota nuk ka më të fshehta, madje edhe nëse ajo struket tash për tash në mjegull. **IOAN ADAM**

Ardian-Christian
KYÇYKU

Puthmëskelet



ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

Puthmë skelet

Roman

Ardian KYÇYKU (pseudonim letrar: **Ardian-Christian Kycyku**) është lindur në Pogradec më 23 gusht 1969. Kreu studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në Fakultetin e Historisë e të Filologjisë, dega gjuhë-letërsi. Është doktor i shkencave filologjike, doktorand në teologji pranë Universitetit Shtetëror të Bukureshtit dhe docent në shkencat humane dhe të komunikimit. Anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Rumanisë, i Shoqatës së Shkrimtarëve të Bukureshtit, i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë dhe i Central European Academy of Science and Art. Dekan i Fakultetit të Arteve dhe Shkencave në Universitetin “Gheorghe Cristea” të Bukureshtit. Vepra letrare të shkruara e të botuara në gjuhën shqipe: *Në perandorinë e gurit, Mortët, Nata pas vitit zero, Përkthimi, Muza e Lojës, Lumenjtë e Saharasë, Oreksi për bukën e qiellit, Diva ose Ngrënësi i Luleve, Engjëjt e tepërt, Kristali dhe hienat, Sy, Si u pushtua Çmendustani, Home, Në vend të Përjetësisë*; në gjuhën rumune: *Viti kur u shpik mjellma, E fshehta e ëmbël e marrëzisë, Një fis i lavdishëm e që jep shpirt, Hyu Epigon, Dashuri me shikim të fundit, Trilogjia, Shtetrrethim - roman i shkruar me shumë pak thonjëza, Ish - roman me dashuri & konspiracion, Empatyon ose Libri i jetës së parakohëshme*; përkthime: *Një alfabet i poezisë shqipe*, antologji, 101 poetë shqiptarë në gjuhën rumune; botime të tjera, përfshi ato didaktike-shkencore: *Koha e zëvendësve*, libër-intervistë kushtuar shpirtëritimit shqiptar, *Hyrje në semiotikë, Shenjat dhe Kështjella* (ligjërrata universitare). Në kuadrin e arsimit të lartë rumun jep lëndët: *Elemente të kulturës dhe qytetërimit ballkanik, Hyrje në semiotikë, Struktura e gjuhës së shtypit, Imagologjia dhe Fenomeni Audiovizual*. Nga viti 1998 është bashkëthemelues dhe bashkëdrejtues i Revistës *Haemus*, që botohet në Bukuresht. Themelues dhe kryeredaktor i revistës universitare *ComunIQue*. Krijime të tij janë përkthyer në gjuhët hungarisht, gjermanisht, spanjisht, anglisht, frëngjisht, italisht.

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

Puthmë skelet

Roman

Motto:

*Kockat tuaja ç'u mblodhë
Një nga një porsi flori
Me qivur të kuq me bojë
Do shkruhi në histori*

Populli (pó ai)

“Të gjitha ngjashëritë janë të rastit”

ose

“Asnjë ngjashmëri nuk është e rastit”.

LibrariumHaemus

2010

ARDIAN-CHRISTIAN KYÇYKU

Puthmë skelet

(roman)

LibrariumHaemus 2010

© **Ardian Kyçyku**

Coperta / Ballina: **Küdesign**

Bucureşti, 2010

ISBN electronic: 978-606-8093-15-4

I

Zotnia që mbijetonte duke gjuajtur emra dhe ripagëzonte qenie e gjëra, aq sa në shumicën e kohës s’dinte ç’emër i shkonte më për shtat atij vetë, – njëlloj sikur të qënkej thjesht një skelet, – ndihej *fryti më i hijshëm* i një ujdje me botën tjetër. Madje ngulmonte se të vdekurit e disa breznive nuk donin tjetërkënd më shumë se atë dhe nuk kishin ende një të dërguar *më të posaçëm* në këtë botë. Provat do t’i kishin tepruar edhe më smirëziut ndër bashkëkohës. Vite më parë, kur ende s’i pat dirsur mustaqja, një dorë e padukshme e pat ftuar mes atyre varreve të pikëlluar, e pat joshur të shkulte një trëndafil të madh që disi ngjante me yllin pesëcepash të flamurit kombëtar, i pat pëshpëritur gjëra që duken tepër foshnjarake për t’u plotësuar dhe e kish nisur drejt shtëpisë së *Amerikës*, kushërirës së largët plakë, që, siç s’ngopeshin së shfryri fqinjët, “*qe ustalleshë e lindur për të groposur pasanikë*”. Varroste burra dhe gdhihej në një gropë tri herë më të thellë me verdhushka se sa një martesë më parë. Nën dritaret e vilës së asaj vejushe, ndjesë pastë, ai *shihte zhgjëndërr* sikur gatitej për dasmë në një muzg të dëbortë dhjetori, teksa përjashta, në kopësht, gushkuqët e trallisur nga

uria rrëmonin për krimba mes skeleteve të trëndafilave. I bëhej se po afroheshin festat e Vitit të Ri. Zilja e telefonit kopjonte një kabanë kishe që paraprihej nga goditjet me çekiç druri mbi një dërrasë vigane, njëfarë porte, dhe dëbonte shpirtrat e këqinj, të pavendosur, të verbuar nga çikërrimat e kësaj jete, ku, sipas tij, vetëm Fjala dhe Femra nuk duheshin hedhur në plehëra. Kur gati mendoj se, larg qoftë, po vishej shik për në qivur, jo për ndonjë dasmë a ditëlindje, kambanat i kujtuan një këngë të hershme qytetare, me dyert që trokasin pas mesnate dhe me vetmitarin që rreket të zgjojë zemrën e vet (*Ngrehu, moj zemër, ngrehu / Se, moj, na thau era*), me portat e shtëpisë *këthyer nga lumi (Ngrehu, moj zemër, ngrehu, / Se, moj, na zuri gjumi)*. Edhe porta e vilës së tij rrinte kthyer nga lumi, domethënë nga ish Lumi i Madh, që ish dyndur për herë të mbrame mbi mëhallë në vjeshtën e vitit '52, a thua se kish nxjerrë shumëkokën nga dheu një bollë legjendash, dhe pat nxjerrë (për të mos thënë *vjellë*) mu në zemër të pllajës me trëndafila, eshtrat e tri duarve të ndryshme, pa kafka, pa rebra kraharori. Dy nga tri duart mbanin ende në gishtat e martesës nga një unazë të madhe ari me rubin e safir në majë. Gurët e çmuar u ngjanin ca syçkave njëfarësoj përqeshëse dhe plot mençuri, që të bindnin tërthorazi se i dinin *më së miri* gjërat që ti luteshe t'i harronte edhe Zoti. Asokohe vejusha ishte ende gjallë dhe magjepsëse. Mbante në heshtje fisnike nofkën “Amerika”, duke pranuar pó në heshtje para atyre që ia patën ngjitur se disa mërgimtarë mezi kishin pritur e prisnin që të vinin ca lekë në kurbet, të ktheheshin në atdhe, t'i përgjëroheshin që ajo t'i merrte për burra e pastaj, pa ndërmjetësinë e asnjë magjie të zezë a pangopjeje me limfë, brenda rreth një viti, të iknin në botën fqinjë, duke i lënë kamje sa për dy breza, ndonëse me asnjërin syresh nuk pat arritur të ngelej shtatzanë. Sikur e patën të shkruar në ballë që të jepnin shpirt në atdhe e të *jepnin flori* para saj. *Amerika* mezi kish pritur që ndonjëri nga të ndjerët t'i linte bashkë me verdhushkat edhe ndonjë djalë, ose vajzë. I pat njomur netët dhe jastëkët me lotë nga ata që njerëzit e rëndomtë nuk i shohin as në zhgjiëndërr. Ndërroi jetë me bindjen se barkun ia pat tharë pikërisht smira e fshehur si ndonjë lebër nën përshëndetje të përditshme, urime të shtirura, bekime e

mallkime fqinjësh, apo babëzi e skëtërrshme grash që s'kuptojnë as me kockë ballit se disa qënie linden me një dhunti të veçantë, me një aromë magneti të padukshëm, që i rrënjos si pusin në mes të shkretisë, dhe të gjithë drithërojnë për të pirë qoftë edhe një gllënjë, apo edhe një pështymë, pa menduar se pusi thahet, pa çarë kokën se po thahet për ta. Ai do ta shqipëronte vite më vonë dhuntinë e Teto Amerikës, në kohën kur thinjat e para do t'i shkisinin anës tëmthave dhe kur ajo ngrohtësia vrastare dhe aq paqtuese e një familjeje të mundshme do ta shtynte të kërkonte si i hazdisur nëpër ëndrra e zhgëndrra ndonjë kalë e t'ia mbathte. T'ia mbathte nga jeta, nga gjumi, nga vetë Kujtesa. Prania e Teto Amerikës zgjonte një frikë tejet të rrallë, si të ardhur nga bota e përkorë ku asgjë e askush s'ka trup. Të mbushte vetiu me një mall të paparë, me një përzierje lotësh fëminie, me shumë lëng jetëdhënës e hidhërim nga ai i dijetarëve apo i murgjve, pastaj të jepej e tëra, duke të çmeritur me dëshmi të panumurta se femrat e kësaj toke nuk ishin të argasura e të vrazhdësuar nga çakërdisjet e historisë – dhe ti rropateshe të mbeteshe oreçast në lartësinë e saj, të ishe të paktën po aq i hollë, i lehtë, marramendës, i beftë, i ndritshëm, apo, sipas rastit: i dhunshëm, i akullt, kafshëror. Dhe pastaj, vetëtimthi, fryma të braktiste, ikte nga bronket e nga dejet e nga venat, bashkë me gjakun, me mallin e me lëngun e shenjtëruar dhe vdisje. Aty kuptoje se me pasurinë që i lije trashëgim, në fakt synoje të shlyeje pamundësinë tënde për të qënë i papërsëritshëm. Vdisje, por vdisje i pajtuar me të gjitha, vdisje me sytë hapur, si i thonë, dhe me një buzëqeshje plot dritë në qënie, duke i uruar asaj femre fatbardhësi, madje duke uruar që edhe të tjerë, sa më shumë të tjerë ta pësonin si ti.

Ai qe lindur me të njëjtën dhunti lartuese e vrastare, – mbase qe gjysma mashkullore e asaj gruaje, – dhe tani mbante në gishtin e martesës njërën nga dy unazat e florinjta të duarve që pat sjellë Lumi i Madh, atë me rubin të kuq si gjaku, domethënë si gjaku i *pahelmuar* nga vogëlimat. Amerika ia pat dhuruar me gjithë shpirt menjëherë pasi ai i pat falur trëndafilin e vjedhur në varrezat e Qytetit të Luleve, siç e pat pagëzuar Komandanti. Qe ngazëllyer jo sikur ai t'i kish dhuruar një lule, apo llafin e shumëpritur të gojës, po sikur ta kish bërë befas

nënë, duke e shpëtuar nga shterpësia e gjatë. *Je si një kalorës nga ata të qëmotshmit*, pat buzëqeshur teto Amerika. *Ose kjo unazë të bëri kalorës, prandaj ta mbash gëzuar*. S’kish rëndësi cili e pat mbajtur në jetën e kaluar. Një unazë e atillë s’mund të përndriste as fatin e as gishtin e ndonjë gërdalle. E drejtë, foli ai në zgjendërr, i bindur se femra e kolme dhe ende e nxehtë pranë tij do të pohonte me një puthje symbyllur, sepse ai gjithmonë kishte të drejtë, kishte vetëm të drejtë, ngaqë shumicën e kohës e kishte të drejtë. Sepse ai “*vetëm kur e kishte ngrëhur ishte gjallë*”. Rënkoji pa i hapur sytë dhe pati njëfarë frike se mos vithet e hatashme të saj, ato vithe të përkryera që i adhuronte vdekshëm edhe nga bota ëngjëllore mund të vrenjteshin, të egërsoheshin dhe, po të lëshonin ndonjë nga ato krismat e turpshme, ishin në gjendje ta ngjitnin çarçafin për tavani. E kapi një e qeshur me lot, pastaj lotët dhe e qeshura iu thanë, sepse kurmi i nxehtë i së dashurës u zhduk, u bë pluhur, u davarit drejt tavanit, kurse tavani mori trajtën e qiellit.

Çarçafi paskësh qënë vetë Vdekja.

Vdekja u ul mbi të si mbrëmja e puthjes së parë, e mbështolli, ia zuri të gjitha vrimat, si të thuash, iu mbështoll edhe rreth zemrës, dhe ai nxori njërën dorë që përfund Vdekjes, dorën e djathtë, se ajo po i hante, – e me sa duket nuk po i hante për të harxhuar pará, po për të shlyer borxhet që i kishte Qiellit, – e nxori me drithërimën e rreme të atyre qyfyrexhinjve të cirkut, hapi grushtin e akulluar nga makthi dhe s’diti ç’do të dilte kur ta hapte: ndonjë pëllumb kokëshkulur, ndonjë trëndafil fatsjellës a fatbjerrës si ai i varrezës, ndonjë tufë kokrrash qymyri, apo thjesht zemra e vet. Zemra që ishte motërzim mistik i të gjithave. Zemra që aq herë, me shaka, në çaste krenarie mashkullore, i pat kujtuar jastëçkat ku gratë çlodhnin gjilpërat. Duhej të kishte aq vrima ajo zemër, sa tani s’kishe ku ta kapje, s’kishe ku ngulje gjilpërën. Jam i sëmurë, mendoi. Duhej të kisha dashuruar më pak. Më ndryshe. Më mendërisht. Se ja, bujt një ditë Zonja Vdekje edhe për një si unë, dhe Zonjës Vdekje nuk i hedh dot hi syve. Zonjën Vdekje nuk e magjeps dot si Zonjën Jetë, që i do të ndërkyerit si puna ime. E pak para se zëri që e shoqëronte qysh nga fëminia, qysh kur pat rënë së pari në dashuri, ta trandte me të papritura, iu vegua fati i vërtetë

prej kalorësi: i dashur për të vdekurit, por që s'ia hidhte dot Vdekjes – i padashur për të gjallët (jo të gjallat!) dhe që ia pat hedhur aq herë, mjeshtërisht, Jetës. Prandaj i pat ecur mbarë deri në atë çast. E pat trajtuar Jetën si të ishte më e larta femër. E kish magjepsur me fjalime, me dehje shkëlqimtare, me këmbime të befta e shajnitëse mendimesh, në vapë e suferinë, në periudha kur është aq varfëri sa as akrepët s'kanë me çfarë të vrasin veten, në kohëra kur fatit i mbetet goja ngrirë në buzëqeshje, kurdo.

- Mos u tut, - i tha Zëri. Erdhi çasti të bëhesh ai që ke dëshiruar.

Dhe ai e njihte mirë humorin e Zërit, e njihte gati më mirë se veten. Zëri ishte, në fakt, pjesa e dukshme e Hiçit. Çasti kur do të bëhej *ai që pat dëshiruar*, qe mbjellë shumë vite më parë, në fillore, gjatë një pasditeje plot aroma e qëndisma drite femënore, pasi atij i pat ardhur radha të jepte një përgjigje që mund të ishte vendimtare. *Çfarë do të bëhesh ti, xhani i mësueses, kur të rritesh*, qe kureshtur Zysha. Kurse atij i qe mbledhur tërë gjaku në kokë dhe qe gjegjur jo si me zë, por si me një shkulum gjaku:

- I vdekur!

Dhe mezi i pat ardhur gjaku në vend nga gajasjet e *bashkëkohësve* (siç do t'i pagëzonte së afërmi shokët e shoqet e klasës). Gajasje me te cilat gjaku i këtyre trojeve tashmë qe rregjur.

Zëri, ose *vëlla Hiçi*, siduket patën bërë shaka. Pa hapur qepallat, sytë iu endën mes dhomës që voziste në paqe dhe u ndalën tek *Portreti*. Pastaj tingujt e kambanave drithëruan ajrin. Mirpo, sipas rregullit stërgjyshor, kambanat bjenë pasi viktimës i ka rrjedhur nga kurmi e gjithë fryma, e gjithë ëndrra për të mbetur i përjetshëm dhe i pazëvendësueshëm. Ai s'kishte kurrjë prej viktime. Tingujt e kuptuan këtë dhe u ëmbëljuan. Nuk lazdroheshin për vdekjen e tij. Arsyeja ishte më e thjeshtë nga sa pritej. Ai nuk kishte as katër miq që t'ia çonin *më* krahë qivurin. Prandaj duhej të matej mirë para se të zinte ndonjë mik të katërt. Sa u përket grave, ato do të grindeshin mesveti se cilat